REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot. Tiranë, më __.__.2022

VENDIM

Nr. 444, datë 01.11.2022

"PËR
PËRFUNDIMIN PARA AFATIT TË KOMANDIMIT TË ZNJ. {…}"

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 01.11.2022, pasi u njoh me materialet e çështjes, me projektvendimin "Për përfundimin para afatit të komandimit të znj. {…}", si dhe me relacionin përkatës mbi këtë projektvendim, përgatitur nga relatori z. Klodian Kurushi,

VËREN

I. TË DHËNA MBI PROCEDURËN DHE STATUSIN E KOMANDIMIT TË ZNJ. {…}

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 79, shkronja "b", të Ligjit nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", si dhe në nenet 53, 54, 57 dhe 58, të Ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", me bashkë propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës dhe të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, me Vendimin nr. 113, datë 09.07.2019 "Për shpalljen e rihapjes së procedurës për komandim të një gjyqtari në pozicionin pedagog i brendshëm në Shkollën e Magjistraturës", ka vendosur: "*1. Të shpallë **rihapjen** e procedurës për paraqitjen e kërkesës nga kandidaturat që vijnë nga radhët e gjyqtarëve, për tu komanduar me pëlqimin e tyre në*

pozicionin e Pedagogut të Brendshëm, në Departamentin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës. Afati i komandimit është deri pesë vjet.... Afati i paraqitjes së kërkesave për komandim në vendin vakant është 3 (tre) javë nga dita e shpalljes se këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor."

2. Brenda afatit të kandidimit për komandimin në pozicionet si më lart kandidoi edhe znj. {…}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
3. Në përfundim të procedurës së komandimit, sipas përcaktimeve të nenit 54 të Ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe atyre të Vendimit të Këshillit nr. 113, datë 09.07.2019, pas vlerësimit të plotësimit të kritereve të komandimit dhe renditjes së kandidatëve, me Vendimin nr. 225, datë 22.10.2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi:" *1. Komandimin e gjyqtares znj. {...} {...} {...} në pozicionin e pedagogut të brendshëm në Departamentin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës, për një afat 5 (pesë) vjeçar. 2. Afati i komandimit* ***fillon më datë 15 nëntor 2019.*** *3. Afati i komandimit mund të ndërpritet nëse Këshilli i Lartë Gjyqësor do të konstatojë cënim të funksionalitetit normal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. 4. Urdhërohet përjashtimi i menjëhershëm i gjyqtares znj. {...} {...} {...} nga procedurat e ndarjes me short të çështjeve gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë*."
4. Këshilli i Lartë Gjyqësor në Mbledhjen Plenare të datës 01.11.2022 me vendimin nr. 443, ndër të tjera ka vendosur: "*Ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të znj. {...}*".
5. Me miratimin e këtij vendimi me propozimin për datën e fillimit të detyrës në Gjykatën e Posaçme të Apelit të znj. {…} është e nevojshme vendimmarrja e Këshillit për zgjidhjen e situatës që lidhet me komandimin e kësaj magjistrateje.
6. Vendimmarrja e Këshillit "*Për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të znj.{...}*", përcakton se kjo e fundit do të fillojë të ushtrojë funksionin si gjyqtare e përhershme në këtë Gjykatë (GjAPKKO).
7. Ushtrimi i funksionit si gjyqtare në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ndikon drejtpërdrejt në pozicionin e komanduar si pedagoge e brendshme në Shkollën e Magjistraturës.

II. KUADRI LIGJOR DHE VLERËSIMI DHE I KËSHILLIT

8. Këshilli vlerëson se: Znj.{…} me kërkesën e bërë për ngritje në detyrë gjatë kohës që është në një pozicion të komanduar si pedagoge e brendshme në Shkollën e Magjistraturës, ka shfaqur vullnetin e saj të plotë dhe të qartë për zhvillimin e karrierës si magjistrate duke kërkuar të ushtrojë funksionin si gjyqtare në një gjykatë të juridiksionit të posaçëm.
9. Situata konkrete e znj.{…} gjen zgjidhje ligjore në Nenin 57 të ligjit 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

10. Neni 57, pika 2 e Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, parashikon se: *"2. Me kërkesë të magjistratit të komanduar, Këshilli, pasi merr mendimin e institucionit ku është komanduar magjistrati, mund të përfundojë kohëzgjatjen e komandimit para afatit, për arsye të justifikuara".* Sipas këtij përcaktimi Këshillit i duhet të vlerësojë këto elementë: i) kërkesën e magjistratit; ii) mendimin e institucionit ku është komanduar magjistrati; dhe iii) arsyet e justifikuara.

i) Kërkesa e magjistratit për përfundimit e komandimit para afatit

11. Me kërkesat për shprehje interesi për ngritje në detyrë në GJPAKKO[1], bazuar në Nenin 48, pika 3, germa "b" të Ligjit 96/2016, "Për statusin" i ndryshuar[2], ku parashikohet se: "*..3. Këshillat shpallin procedurën e ngritjes në detyrë dhe bëjnë thirrje që të kandidojë: b**) magjistrati i komanduar** ose magjistrati në skemën e delegimit që plotëson kriteret për ngritjen në detyrë, në përputhje me kërkesat e pozicionit të lirë të shpallur."* magjistratja e komanduar Znj. {…} ka shfaqur vullnetin për të vijuar karrierën e saj si magjistrate në GJPAKKO.
12. Ngritja në detyrë siç është rasti objekt shqyrtimi është pjesë e zhvillimit të karrierës të magjistratit. Zhvillimi i karrierës në përgjithësi dhe ngritja në detyrë vihen në lëvizje/fillojnë, *detyrimisht* me kërkesë të magjistratit përkatës drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor.
13. Në datën 14.04.2021 znj.{…}, ndërkohë që ishte e komanduar si pedagoge në Shkollën e Magjistraturës ka dorëzuar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor kërkesën për shprehjen e interesit për të kandiduar për pozicionet e lira të shpallura nga Këshilli. Magjistratja e komanduar ka dorëzuar së bashku me kërkesën edhe dokumentet shoqërues sipas vendimeve nr. 117, 118 dhe 119 datë 01.04.2021 të Këshillit.
14. Shprehja e interesit, për ngritje në detyrë nga magjistrati, që është një formë e zhvillimit të karrierës së tij, do të thotë që magjistrati përzgjedh me vullnetin e tij këtë formë të mëtejshme të zhvillimit të karrierës së tij. Në këtë kuptim, magjistrati duke përzgjedhur për zhvillimin e karrierës së tij, alternativën e ngritjes në detyrë në një gjykatë të specializuar, ka hequr dorë nga mundësia e zhvillimit të karrierës në pozicionin e komanduar si pedagoge e brendshme në Shkollën e Magjistraturës, duke përfshirë edhe vullnetin e kandidates që gjendet i pasqyruar në kërkesën e saj për kandidime.
15. Në këto rrethana, duke vlerësuar sjelljen e magjistrates sipas Nenit 48, pika 3, germa "b" dhe Nenit 57 pika 2 të ligjit 96/2016, znj. {…} ka dashur të përfundojë para afatit komandimin në Shkollën e Magjistraturës, për shkak se ajo tashmë është e lidhur me kërkesën, procesin, përzgjedhjen dhe ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

ii) mendimi i institucionit ku është komanduar magjistrati

[1] Për pozicionet e shpallura me Vendimet nr. 117, nr.118, dhe nr.119 datë 01.04.2021.
[2] **Neni 48** i ligjit 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë"

16. Kriteri i dytë ligjor i parashikuar nga Neni 57/2 i ligjit 96/2016 "Për statusin" është dhënia e mendimit nga institucioni përkatës ku është komanduar magjistrati, në këtë rast Shkolla e Magjistraturës.
17. Këshilli dhe Shkolla e Magjistraturës kanë qenë në vijimësi në komunikim shkresor lidhur me kandidimet e znj.Merkaj për ngritjen në detyrë. Komunikimi ka qenë i nevojshëm për arsye të kryerjes nga ana e Shkollës së Magjistraturës vlerësimi etik dhe profesional i znj.{…} për periudhën e ushtrimit të funksionit të pedagoges së brendshme, vlerësim i cili është pjesë e procedurës së ngritjes në detyrë.
18. Për këtë qëllim, Shkolla ka përcjellë në Këshill "Formularin e vlerësim të pedagogut të brendshëm" për znj. {…}" duke kontribuar në këtë mënyrë në ngritjen në detyrë të kësaj magjistrateje.
19. Në vijim të komunikimeve të mëparshme, Këshilli i është drejtuar Shkollës së Magjistraturës – si institucioni ku është komanduar magjistratja {…} me kërkesën datë 21.10.2022 me lëndë "Kërkesë për dhënie mendimi". Kjo shkresë ndër të tjera ka këtë përmbajtje "... *Në kushtet kur ka filluar viti akademik 2022-2023 dhe aktualisht znj. {...} është pedagoge e brendshme në Departamentin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës, kërkojmë mendimin tuaj nëse afati i propozuar për fillimin e ushtrimit të funksionit të znj.{...} në Gjykatën e Posaçme të Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, është i përshtatshëm për ju dhe nuk cenon procesin e mësimdhënies*."
20. Shkolla e Magjistraturës me shkresën nr. 456/2 prot., datë 24.10.2022 ka rikonfirmuar qëndrimin e mëparshëm për ngritjen në detyrë të znj.{…} dhe është shprehur se: "*Në përgjigje të shkresës tuaj, me titull "Kërkesë për dhënie mendimi", protokolluar me tonën nr.453/3, datë 21.10.2022, ju vëmë në dijeni se largimi i znj.{...} nga detyra e pedagoges së brendshme, nuk cenon procesin e mësimdhënies në Shkollën e Magjistraturës".*

iii) arsyet e justifikuara për përfundimin para afatit të komandimit

21. Elementi i tretë i cili është marrë në analizë sipas Nenit 57 të ligjit 96/2016 "Për statusin" - arsyet e justifikuara.
22. Këshilli i Lartë Gjyqësor i ka kushtuar rëndësi të madhe veprimtarisë së plotë të gjykatave të posaçme në drejtim të funksionalitetit. Plotësimit i vakancave të përhershme në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar përbën një prioritet dhe një sfidë për KLGJ. Gjithashtu plotësimi i vakancave në këtë gjykatë vijon të jetë një nga Rekomandimet që Kuvendi i Shqipërisë kishte për KLGJ-në për vitin 2022. Interesi publik të drejtim të funksionalitetit të plotë të GjPAKKO vlerësohet si një arsye e justifikuar në kuptim të Nenit 57/2 të ligjit 96/2016 "Për statusin".
23. Nga ana tjetër e drejta e magjistratit për të zhvilluar karrierën duke u ngritur në detyrë në një gjykatë të specializuar konsiderohet si një arsye tjetër e justifikuar për përfundimin e komandimit përpara afatit.

III. Konkluzione

24. Ndodhur në këto kushte, kur:

i. Është i qartë vullneti i gjyqtares {…} për të përfunduar para afatit komandimin e saj si pedagoge e brendshme në Shkollën e Magjistraturës dhe për të vijuar karrierën e mëtejshme me ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;

ii. Mendimi i Shkollës së Magjistraturës se largimi i znj. {…} nga detyra e pedagoges së brendshme, nuk cenon procesin e mësimdhënies;

iii. Arsyet e justifikuara për interesin publik që paraqet funksionaliteti i plotë i GjPAKKO dhe e drejta e magjistratit për të zhvilluar karrierën në një tjetër aspekt, atë të ngritjes në detyrë në një gjykatës së specializuar.

25. Këshilli vlerëson se plotësohen kriteret ligjore të parashikuara nga Neni 57/2 i ligjit 96/2016 "Për statusin" për përfundimin përpara afatit të komandimit të znj. {…}.

PËR KËTO ARSYE

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 61, 86, shkronja "d" dhe 97 të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, në nenin 57, të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe në Vendimin e tij nr. 225, datë 22.10.2019 "Për komandimin e gjyqtares {…} {…} {…} në pozicionin e pedagogut të brendshëm në Departamentin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës" vendimin nr. 443, datë 01.11.2022 të Këshillit, "Për ngritjen në detyrë të gjyqtarit të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të znj. {…}",

V E N D O S I

1. Përfundimin para afatit të komandimit të gjyqtares znj. {…} në pozicionin e pedagogut të brendshëm në Departamentin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës.
2. Efektet e këtij vendimi fillojnë më datë 06.11.2022.
3. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares znj. {…} sipas kërkesave të shkronjës "c", pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Shkollës së Magjistraturës.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

Kryetare
NAUREDA LLAGAMI

Anëtar
KLODIAN KURUSHI

Anëtare
BRIKENA UKPERAJ

Anëtare
FATMIRA LULI

Anëtare
IRENA PLAKU

Anëtare
MARÇELA SHEHU

Anëtar
RIDVAN HADO

Anëtar
ALBAN TORO